



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

UDHËZIM PËR APLIKANTËT
Programi Studimi i Formimit të Vazhduar
“Përkthim Teknik, Letrar dhe Interpretim”

Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës njofton të gjithë të interesuarit për çeljen e aplikimeve për ndjekjen e **moduleve të programit të formimit të vazhduar “Përkthim Teknik, Letrar dhe Interpretim”**, një program trajnimi profesional që synon zhvillimin e kompetencave të avancuara në përkthim dhe interpretim në fusha të specializuara.

Ky program është konceptuar në përputhje me **Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (niveli 7-3)** dhe ofron **mikrokredenciale universitare** të lëshuara nga Universiteti i Tiranës. Programi është i hapur për profesionistë të gjuhëve të huaja, përkthyes, interpretë, si edhe për të diplomuar që dëshirojnë të zhvillojnë aftësi të specializuara në fushën e përkthimit teknik, juridik, ekonomik, mjekësor, turistik dhe letrar.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i formimit të vazhduar “Përkthim Teknik, Letrar dhe Interpretim” synon zhvillimin e kompetencave profesionale në fushën e përkthimit dhe interpretimit në sektorë të ndryshëm si drejtësia, ekonomia, mjekësia, turizmi, legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe përkthimi letrar.

Programi është i organizuar në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (niveli 7-3) dhe ofron module trajnimi të vlerësuara me mikrokredenciale universitare. Pas përfundimit të modulit, pjesëmarrësit pajisen me **certifikatë nga Universiteti i Tiranës**.

STRUKTURA E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi përbëhet nga **11 module të pavarura**, secili me:

- **30 orë mësimore**
- **3 kredite ECTS**
- **certifikim nga Universiteti i Tiranës**
- Trajnimet zhvillohen përgjatë vitit akademik në dy periudha si më poshtë:

PERIUDHA DHE KOHËZGJATJA E TRAJNIMEVE

Trajnimet do të jenë intensive dhe do të zhvillohen përgjatë vitit akademik në dy periudha si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Periudha I: Maj – Qershor 2026

Periudha II: Shtator – Tetor 2026

Çdo modul zhvillohet në maksimumi **6 javë mësimore**, çdo të shtunë nga 5 orë.

Modulet nuk janë të ndërvarura dhe mund të ndiqen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra.

MODULET E OFRUARA PËR TRAJNIM

Programi përfshin trajnim në këto fusha të specializuara:

1. Përkthim teknik në fushën e së drejtës civile
2. Përkthim teknik në fushën e së drejtës penale
3. Përkthim teknik në fushën e legjislacionit të Bashkimit Evropian
4. Përkthim automatik dhe përdorimi i mjeteve CAT
5. Interpretim juridik
6. Interpretim konsektiv A-B / B-A
7. Interpretim simultan A-B / B-A
8. Përkthim teknik në fushën e ekonomisë
9. Përkthim teknik në fushën e turizmit dhe trashëgimisë kulturore
10. Përkthim teknik në fushën e mjekësisë
11. Përkthim letrar

GJUHËT E TRAJNIMIT

Trajnimet do të zhvillohen në gjuhët shqip + një nga gjuhët e mëposhtme:

- Anglisht
- Frëngjisht
- Gjermanisht
- Italisht
- Spanjisht
- Greqisht
- Turqisht
- Rusisht

FORMA E ORGANIZIMIT TË TRAJNIMEVE

Trajnimet zhvillohen përgjatë vitit akademik në dy periudha:

Periudha I:

Maj – Qershor 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Periudha II:

Shtator – Tetor 2026

Secili modul zhvillohet në maksimum **6 javë mësimore**, çdo të shtunë nga 5 orë mësimore.

Mësimdhënia zhvillohet në formë **hibride**, duke kombinuar aktivitetet në auditor me komponentët online.

Provimi përfundimtar do të zhvillohet fizikisht në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

DATA TË RËNDËSISHME

Hapja e aplikimeve:	1 prill 2026
Mbyllja e aplikimeve:	15 prill 2026
Njoftimi i fillimit të trajnimit:	25 prill
Fillimi i trajnimit:	Maj 2026

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Në programin e formimit të vazhduar mund të aplikojnë:

- Kandidatë që kanë përfunduar studimet e larta (*Master ose Doktoraturë*);
- Profesionistë që punojnë në fushën e përkthimit ose interpretimit;
- Kandidatë me diplomë ekuivalente nga universitete të huaja;

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Aplikantët duhet të dorëzojnë:

- Diplomën e fundit të studimeve (kopje të noterizuar);
- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje të dokumentit të identitetit;
- Mandatin e pagesës së modulit.

VENDI I APLIKIMIT

- Plotësimi i formularit online në faqen web: [Formular regjistrimi për Module Trajnimesh të Formimit të Vazhduar “Përkthim Teknik, Letrar dhe Interpretim” - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja](#)
- Nëpërmjet adresës elektronike të dedikuar: trajnimefgj@unitir.edu.al
- Ose fizikisht pranë: **Degës së Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**

TARIFA PËR ÇDO MODUL TRAJNIMI

Tarifa për ndjekjen e një moduli është: **15.000 Lekë**

Pagesa kryhet në momentin e regjistrimit për modulën përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

REGJISTRIMI

Të gjithë aplikantët të regjistruar bashkë me mandatin e pagesës, do të njoftohen mbi modalitetet e fillimit të trajnimit.

CERTIFIKIMI NË FUND TË MODULIT

Pjesëmarrësit duhet të frekuentojnë 80% të leksioneve të modulit të trajnimit.

Pas përfundimit me sukses të modulit dhe plotësimit të detyrimeve akademike, pjesëmarrësit pajisen me: **Certifikatë nga Universiteti i Tiranës.**

Në certificate shënohen kreditet e fituara për ndjekjen e çdo moduli trajnimi, **3 ECTS** së bashku me pikët e vlerësimit.